



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1323/9 Prot.

Durrës, më 19.05.2025

VENDIM

Nr. 57, datë 19.05.2025

PËR

**"MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË DREJTORISË SË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR
MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në shkresën Nr. 1065 prot., datë 08.04.2025 të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit; si dhe në relacionin e Drejtorisë Juridike me Nr. 1065/1 prot., datë 12.05.2025, në mbledhjen e datës 19.05.2025, Senati Akademik,


VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së brendshme të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit Në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





RREGULLORE E BRËNDSHME E DREJTORISË SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

(DTI)

*Miratuar me Vendimin Nr. 57, datë 19/05/2025 të Senatit Akademik të Universitetit
"Aleksandër Moisiu" Durrës*

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20 dhjetor 2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", si Institucion i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Republikën e Shqipërisë.

Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit është miratuar në strukturën administrative sipas Vendimit nr. 62, datë 19/11/2024 të Bordit të Administrimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.

HYRJE

Në "Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor", Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Statutit si dhe Rregullores së brendshme të UAMD, kjo rregullore synon të rregullojë funksionimin e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit. Në epokën e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) ka për qëllim të sigurojë një infrastrukturë të fortë teknologjike për të mbështetur procesin akademik dhe administrativ. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) ka një rol kyç në garantimin e funksionimit të sistemeve dhe shërbimeve IT, duke përmirësuar përvojën e përdoruesve dhe duke siguruar standarde të larta të sigurisë kibernetike. DTI ka për detyrë të sigurojë administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve të informacionit dhe rrjeteve kompjuterike të universitetit, si dhe të promovojë inovacionin dhe transformimin digjital në të gjitha nivelet e institucionit.

Kjo rregullore përcakton strukturën, përgjegjësitë dhe funksionimin e kësaj drejtorie në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi."

II. STRUKTURA DHE PËRGJEGJËSITË


Neni 4

Struktura Organizative

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI), është miratuar në strukturën administrative sipas Vendimit nr. 62, datë 19.11.2024 të Bordit të Administrimit të Universitetit “Aleksandër Mosiu” Durrës.

Kjo drejtori është e përbërë nga:

1. Drejtori
2. Sektori i Mirëmbajtjes Teknike (1 Përgjegjës, 5 Specialistë)
3. Sektori i Inovacionit dhe Softuerit (1 Përgjegjës, 6 Specialistë)



III. DREJTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Neni 5

Roli dhe Përgjegjësitë

- Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, është autoriteti më i lartë i kësaj Drejtorie.
- Drejtori ka varësi të drejtpërdrejtë nga Rektori i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Gjithashtu realizon detyra të ngarkuara nga Administratori i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.
- Drejtori i kësaj drejtorie koordinon, bën ndarjen e punëve dhe ndjek zbatimin e detyrave të caktuara sipas sektorëve që ka nën varësi.
- Drejtori i drejtorisë raporton mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat që hasen gjatë realizimit të detyrave.
- Është përgjegjës për shpërndarjen e punës mes përgjegjësve të sektorëve dhe specialistëve të saj drejtorie në përputhje me ligjet, vendimet, udhëzimet e miratuara apo procedurat dhe standartet e tjera, me qëllim që të sigurohet cilësia, sasia, realizimi në kohë dhe me rezultate të matshme lidhur me objektivat e planifikuara.
- Jep konsulencë dhe bashkëpunon teknikisht me stafin e drejtorisë për hartimin dhe zbatimin e detyrave dhe planeve të punës.
- Asiston në përcaktimin e risqeve, që mund të hasen dhe garanton që këto risqe të mbahen në nivele të ulëta brenda drejtorisë.
- Është përgjegjës për menaxhimin e kohës së punës dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në dispozicion.
- Përfaqëson Drejtorinë në marrdhënie me të tretë.
- Menaxhon dhe mbikqyr veprimtarinë e sektorëve të drejtorisë.
- Informon direkt Rektorin për problemet e dala nga kjo drejtori.

IV. SEKTORI I MIRËMBAJTJES TEKNIKE

Neni 6

Përshkrimi

Sektori i Mirëmbajtjes Teknike është një nga njësitë kyçe të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit (DTI) në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD). Ky sektor ka një rol themelor në garantimin e funksionimit të vazhdueshëm dhe të sigurt të infrastrukturës teknologjike të universitetit. Me një ekip të përbërë nga një përgjegjës

sektori dhe pesë specialistë, ky sektor mbulon një gamë të gjerë detyrash që përfshijnë instalimin, mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e pajisjeve dhe sistemeve informatike në të gjithë universitetin.

Neni 7

Objektivat Kryesore të sektorit

Ky sektor ka disa objektiva të qarta që synojnë të rrisin performancën e infrastrukturës teknologjike të universitetit. Këto përfshijnë:

1. **Sigurimi i funksionimit të pandërprerë të pajisjeve IT** në të gjitha ambientet e universitetit.
2. **Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e rrjetit të universitetit**, përfshirë serverat, kabllot e rrjetit dhe pajisjet e tjera të lidhjes.
3. **Zbatimi i protokolleve të sigurisë** për të mbrojtur të dhënat dhe komunikimet brenda universitetit.
4. **Reagimi i shpejtë ndaj incidenteve teknike**, duke garantuar një ndërhyrje efektive për të minimizuar kohën e ndërprerjes së shërbimeve.
5. **Modernizimi dhe azhurnimi i infrastrukturës** për të mbajtur universitetin të përditësuar me zhvillimet më të fundit në fushën e teknologjisë së informacionit.

Neni 8

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Sektori i Mirëmbajtjes Teknike ka disa detyra dhe përgjegjësi që sigurojnë funksionimin e duhur të pajisjeve dhe sistemeve IT në UAMD:

a) Instalimi dhe Konfigurimi i Pajisjeve IT

Një nga detyrat kryesore të sektorit është instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve IT, duke përfshirë kompjuterët, printerët, skanerët, projektorët dhe pajisjet e tjera të lidhura me teknologjinë e informacionit. Çdo pajisje e re duhet të konfigurohet dhe testohet për të siguruar që është funksionale dhe përputhet me nevojat e universitetit.

b) Mirëmbajtja dhe Riparimi i Pajisjeve

Mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve është e domosdoshme për të parandaluar probleme të mëdha që mund të ndikojnë në mbarëvajtjen e punëve akademike dhe administrative.

Sektori kryen kontrolle të vazhdueshme për të identifikuar defekte ose mangësi dhe ndërhyrjet për t'i riparuar ato.

c) Administrimi i Rrjetit dhe Sigurisë

Rrjeti i universitetit është themeli mbi të cilin mbështeten të gjitha shërbimet digjitale, përfshirë email-et, menaxhimin e të dhënave dhe komunikimet online. Sektori i Mirëmbajtjes Teknike është përgjegjës për monitorimin dhe menaxhimin e rrjetit, duke përfshirë konfigurimin e router-ave, switch-eve dhe serverave për të garantuar një performancë optimale.

d) Monitorimi dhe Menaxhimi i Serverave

Sektori administron serverat e universitetit, duke u siguruar që ato të funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt. Kjo përfshin përditësimin e softuerëve të serverit, monitorimin e ngarkesës së rrjetit dhe sigurimin e mbrojtjes ndaj sulmeve kibernetike.

e) Mbështetja Teknike për Stafin Akademik dhe Administrativ

Një pjesë e rëndësishme e punës së sektorit është mbështetja teknike për stafin akademik dhe administrativ. Kjo përfshin ndihmën për përdorimin e pajisjeve dhe softuerëve, trajtimin e problemeve teknike dhe sigurimin e një shërbimi të shpejtë për të minimizuar ndërprerjet në punën e stafit.

f) Implementimi i Politikave të Sigurisë Kibernetike

Sektori zbaton masa të rrepta të sigurisë kibernetike për të mbrojtur të dhënat dhe sistemet e universitetit nga sulmet e jashtme dhe kërcënimet e brendshme. Kjo përfshin përdorimin e firewall-ve, sistemet e enkriptimit të të dhënave dhe strategjitë e mbrojtjes kundër malware-ve dhe viruseve.

g) Auditimi dhe Dokumentimi i Infrastrukturës IT

Një detyrë tjetër kyçe e sektorit është auditimi i infrastrukturës IT për të vlerësuar performancën dhe për të identifikuar zonat që kërkojnë përmirësime. Gjithashtu, sektori i takon të dokumentojë të gjitha ndryshimet dhe përmirësimet e bëra në sistem për të siguruar një historik të plotë të infrastrukturës teknologjike të universitetit.

Neni 9

Përgjegjësi i Sektorit

- Përgjegjësi i Sektorit të Mirëmbajtjes Teknike ka detyrën të sigurojë funksionimin efikas të këtij sektori dhe të garantojë mbarëvajtjen e punës.
- Ai është përgjegjës për koordinimin e specialistëve dhe shpërndarjen e detyrave në përputhje me prioritetet dhe nevojat e universitetit.
- Harton planet e mirëmbajtjes dhe siguron zbatimin e tyre në mënyrë të rregullt dhe në kohën e duhur.
- Identifikon problematikat teknike dhe rekomandon zgjidhje për to, duke raportuar periodikisht te Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.
- Përcakton dhe monitoron zbatimin e procedurave të sigurisë, duke u siguruar që të gjitha veprimtaritë e sektorit janë në përputhje me politikat teknologjike të universitetit.
- Përveç përgjegjësive kryesore, ai realizon edhe detyra të tjera sipas udhëzimeve të Drejtorit të DTI.
- Organizon dhe drejton punën e sektorit duke respektuar ligjet, vendimet dhe udhëzimet në fuqi, si dhe afatet e përcaktuara për secilin proces.
- Bashkëpunon ngushtë me drejtoritë e tjera dhe fakultetet për të siguruar kushte optimale për funksionimin normal të administratës dhe stafit akademik.
- Koordinon dhe mbikëqyr punën e specialistëve të sektorit, duke u caktuar detyra sipas përgjegjësive dhe duke analizuar zbatimin e tyre.
- Kur vëren moszbatim të detyrave ose shkelje të rregullave, propozon masa administrative për punonjësit e vartësisë që nuk përmbushin përgjegjësitë e tyre sipas akteve ligjore dhe rregulloreve në fuqi.
- Përmbush detyrat e tij në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara nga eprori i tij i drejtpërdrejtë.
- Nuk mund të largohet nga vendi i punës pa miratimin ose lejen paraprake të Drejtorit të Drejtorisë.

Neni 10

Detyrat e Specialistit të Sektorit të Mirëmbajtjes Teknike

- Specialisti i Sektorit të Mirëmbajtjes Teknike punon nën drejtimin e drejtpërdrejtë të Përgjegjësit të Sektorit.
- Ai realizon të gjitha detyrat e përcaktuara sipas ndarjes së punës dhe vepron pas miratimit të Përgjegjësit të Sektorit.

- Përgjegjësia kryesore e specialistit është të kryejë detyrat teknike të përditshme dhe të garantojë funksionimin e vazhdueshëm të pajisjeve dhe sistemeve teknologjike të universitetit.
- Ai angazhohet në identifikimin dhe zgjidhjen e menjëhershme të problemeve teknike.
- Kryen konfigurimin dhe përditësimin e pajisjeve harduerike dhe softuerike.
- Monitoron rrjetin e universitetit dhe implementon përmirësime teknologjike për të rritur efikasitetin dhe sigurinë.
- Siguron një komunikim efektiv me përdoruesit, duke ofruar asistencë për zgjidhjen e problemeve teknike.
- Është përgjegjës për raportimin periodik dhe të rastësishëm mbi çështjet teknike të ngarkuara nga Përgjegjësi i Sektorit.
- Përbush detyrat e tij brenda afateve kohore të përcaktuara nga eprori i tij i drejtpërdrejtë.
- Nuk mund të largohet nga detyra pa lejen ose miratimin paraprak të Përgjegjësit të Sektorit.

V. SEKTORI I INOVACIONIT DHE SOFTUERIT

Neni 11

Përshkrimi

Sektori i Inovacionit dhe Softuerit në UAMD është një njësi thelbësore që siguron zhvillimin dhe implementimin e teknologjive të reja në mësimdhënie dhe administratë. Përmes automatizimit të proceseve, rritjes së sigurisë dhe inovacionit të vazhdueshëm, ky sektor kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e shërbimeve të universitetit, duke e pozicionuar UAMD-në si një institucion lider në fushën e teknologjisë së informacionit në arsimin e lartë në Shqipëri.

Neni 12

Objektivat e Sektorit

Sektori i Inovacionit dhe Softuerit ka një sërë objektivash strategjike që ndihmojnë në përmirësimin e ekosistemit teknologjik të universitetit. Objektivat kryesore përfshijnë:

- Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve akademike dhe administrative për menaxhimin e informacionit.
- Automatizimin e proceseve për të përmirësuar efikasitetin dhe për të reduktuar ndërhyrjet manuale.

- Krijimin e platformave digjitale për të mbështetur mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.
- Sigurimin e përputhshmërisë së sistemeve me rregullat e sigurisë dhe mbrojtjen e të dhënave.
- Integrimin e teknologjive të reja në procesin akademik dhe administrativ për të përmirësuar përvojën e përdoruesit.
- Testimin dhe auditimin e softuerëve për të siguruar funksionalitet optimal dhe për të shmangur dobësitë teknike.
- Ofrimin e trajnimeve dhe asistencës për përdoruesit mbi sistemet dhe aplikacionet e reja të implementuara.

Neni 13

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Sektorit

Sektori i Inovacionit dhe Softuerit ka një gamë të gjerë përgjegjësish që sigurojnë zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive të avancuara në universitet. Disa nga detyrat kryesore të sektorit janë:

a) Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Softuerëve

Ky sektor është përgjegjës për krijimin dhe zhvillimin e softuerëve të personalizuar që ndihmojnë në përmirësimin e operacioneve të universitetit. Softuerët mund të përfshijnë sisteme për menaxhimin e studentëve, platformat e mësimdhënies online, aplikacionet për vlerësimin e stafit dhe studentëve, si dhe bazat e të dhënave për administratën universitare.

b) Implementimi i Platformave Digjitale

Sektori ka për detyrë të zbatojë dhe integrojë sistemet digjitale në mjedisin akademik dhe administrativ. Kjo përfshin platforma si Moodle për mësimdhënie online, sistemet e menaxhimit të dokumenteve, platformat e komunikimit të brendshëm dhe sistemet e regjistrimit elektronik.

c) Automatizimi i Proceseve Akademike dhe Administrative

Një nga objektivat kryesore të sektorit është automatizimi i procedurave për të rritur efikasitetin dhe për të reduktuar ngarkesën e punës. Kjo përfshin zhvillimin e sistemesh për menaxhimin e dosjeve të studentëve, regjistrimin e notave, proceset e aplikimit dhe sistemet e menaxhimit të burimeve njerëzore.

d) Siguria e të Dhënave dhe Përdorimi i Teknologjive të Avancuara

Ky sektor është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e sigurisë së sistemeve, duke siguruar që të dhënat e studentëve dhe stafit të mbrohen nga kërcënimet kibernetike. Ai implementon protokolle sigurie si kriptimi i të dhënave, identifikimi me shumë faktorë dhe backup-et automatike për të parandaluar humbjen e të dhënave.

e) Inovacioni dhe Eksplorimi i Teknologjive të Reja

Sektori ka një rol të rëndësishëm në hulumtimin dhe aplikimin e teknologjive të reja që mund të ndihmojnë universitetin të mbetet i përditësuar me zhvillimet më të fundit në fushën e IT-së. Kjo përfshin përdorimin e Inteligjencës Artificiale për analizën e të dhënave akademike, Blockchain për sigurinë e dokumenteve dhe Realitetin Virtual për simulime akademike.

f) Mbështetja Teknike dhe Trajnimet për Përdoruesit

Një pjesë e rëndësishme e punës së sektorit është mbështetja teknike për përdoruesit, duke përfshirë stafin akademik, administrativ dhe studentët. Ai organizon trajnime për përdorimin e softuerëve dhe platformave të reja dhe siguron ndihmë teknike për çdo problem të mundshëm.

Neni 14

Roli i Përgjegjës të Sektorit të Inovacionit dhe Software

- Përgjegjësi i Sektorit të Inovacionit dhe Softuerit ka detyrën të sigurojë zhvillimin dhe funksionimin efikas të këtij sektori, duke garantuar mbarëvajtjen e punës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të platformave dhe sistemeve softuerike të universitetit.
- Ai është përgjegjës për koordinimin e specialistëve të sektorit dhe shpërndarjen e detyrave në përputhje me prioritetet dhe nevojat teknologjike të universitetit, duke u siguruar që projektet softuerike të zhvillohen sipas afateve dhe kërkesave të përcaktuara.
- Harton strategjitë dhe planet e zhvillimit të softuerëve dhe siguron që ato të implementohen dhe mirëmbahen në mënyrë të rregullt dhe efikase.
- Identifikon problematikat teknike në sistemet ekzistuese, propozon përmirësime dhe zgjidhje inovative, duke raportuar periodikisht te Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit mbi progresin e projekteve dhe sfidat e hasura.

- Monitoron dhe përcakton procedurat e sigurisë dhe përputhshmërinë me rregulloret teknologjike të universitetit, duke u siguruar që të dhënat dhe sistemet të mbrohen nga rreziqet kibernetike.
- Përveç përgjegjësi kryesore, ai realizon edhe detyra të tjera sipas udhëzimeve të Drejtorit të DTI, duke kontribuar në strategjinë e përgjithshme teknologjike të universitetit.
- Organizon dhe drejton punën e sektorit, duke zbatuar ligjet, vendimet dhe udhëzimet në fuqi, si dhe duke ndjekur afatet e përcaktuara për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e softuerëve dhe platformave digjitale.
- Bashkëpunon ngushtë me fakultetet dhe drejtoritë e tjera për të siguruar përshtatjen e softuerëve dhe zgjidhjeve teknologjike me nevojat akademike dhe administrative të universitetit.
- Koordinon dhe mbikëqyr punën e specialistëve të sektorit, duke shpërndarë detyrat sipas specializimeve dhe objektivave të institucionit, si dhe duke analizuar zbatimin e tyre për të siguruar efikasitet dhe cilësi të lartë në shërbimet digjitale të universitetit.

Neni 15

Roli i Specialistit të Sektorit të Inovacionit dhe Software

- Specialisti i Sektorit të Inovacionit dhe Softuerit punon nën drejtimin e drejtpërdrejtë të Përgjegjësit të Sektorit dhe ndjek udhëzimet e tij për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e aplikacioneve dhe platformave digjitale të universitetit.
- Ai realizon të gjitha detyrat e përcaktuara sipas ndarjes së punës dhe vepron pas miratimit të Përgjegjësit të Sektorit për çdo implementim të ri ose ndryshim në sistemet ekzistuese.
- Përgjegjësia kryesore e specialistit është të zhvillojë, testojë dhe mirëmbajë aplikacionet dhe sistemet softuerike, duke siguruar funksionimin optimal dhe përmirësimet e nevojshme.
- Angazhohet në identifikimin, analizimin dhe zgjidhjen e problemeve teknike në platformat digjitale dhe softuerët e universitetit për të shmangur ndërprerjet në funksionimin e tyre.
- Kryen kodimin, optimizimin dhe përditësimin e aplikacioneve, si dhe implementon përmirësime teknologjike në sistemet e përdorura nga universiteti.
- Monitoron performancën e softuerëve dhe sigurinë e tyre, duke zbatuar protokolle të sigurisë kibernetike dhe duke ndjekur standardet më të mira për mbrojtjen e të dhënave.

- Siguron një komunikim efektiv me përdoruesit, duke ofruar asistencë teknike dhe trajnime për stafin akademik dhe administrativ mbi përdorimin e sistemeve të reja dhe të përmirësuara.
- Është përgjegjës për raportimin periodik dhe të rastësishëm mbi statusin e projekteve softuerike, problemet teknike dhe përmirësimet e nevojshme, duke informuar Përgjegjësin e Sektorit.
- Përbush detyrat e tij në përputhje me afatet kohore të përcaktuara nga eprori i tij i drejtpërdrejtë, duke siguruar zbatimin e planit të zhvillimit të teknologjisë në universitet.
- Nuk mund të largohet nga detyra pa lejen ose miratimin paraprak të Përgjegjësit të Sektorit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16

Njohja me rregulloren

Të gjithë punonjësit e Drejtorisë duhet të njihen individualisht me këtë rregullore.

Kriteret dhe përmbajtja e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë punonjësit e Drejtorisë. Me pranimin në punë, punonjësi njihet dhe pranon kërkesat e kësaj Rregulloreje. Rektori nxjerr urdhra dhe udhëzime për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Çdo punonjës pajiset me një kopje të Rregullores së Brendshme.

Neni 17

Sanksione

Mosrepektimi i rregullores përbën shkak për procedim disiplinor për çdo punonjës që shkel rregulloren, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kur nuk përbën vepër penale). Në sa më sipër, shkelja e rregullores, do të sjellë vendosjen e sanksioneve administrative në bazë të "Kodit të Punës" si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Mosnjohja e rregullores, nuk e justifikon punonjësën nga përgjegjësia dhe sanksionet e lartpërmendura.

Neni 18

Ndryshimi, zëvendësimi, shtimi dhe shfuqizimi i dispozitave

Dispozitat e kësaj rregulloreje do të ndryshohen, zëvendësohen, shtohen dhe shfuqizohen me vendim të Senatit Akademik.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj në Senat Akademik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.